

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023*

10.05.2023

Ora, 14:06

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të disa subjekteve vetëdeklarues, kandidatë për anëtarë në këshillin bashkiak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti Politike:**                                      **S’ka**
- **Të tjerë:**    **KRIIK**

*Z. I. Celibashi:* Mirdita! Atëherë seanca e sotme ka në rendin e ditës çështjet vijuese, projektvendimet që lidhen me verifikimet e të dhënave të deklaruara në formularët e vetëdeklarimit për disa subjekte vetdeklarues, kandidatë për këshilla bashkiakë. Kemi shqyrtimin e raportimit të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike për periudhën 21 prill - 27 prill, si dhe denoncimet me nr. 342, 343, 344, 345, 346 të deputetes, zonjës Albana Vokshi, të cilat lidhen me këtë periudhë, si dhe denoncime të tjera, që lidhen po me këtë periudhë të koalicionit

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

“Për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”, si dhe të zotit Ivi Kaso, në emër të koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Pastaj kemi shpalljen e vendimeve për denoncimet nr. 210, 237, 238, 239, 240, 241, 242, dhe 326, denoncime këto të organizatës KRIIK. Kemi vlerësimin e raportit të Autoritetit të Medies Audiovizive për periudhën 1-5 maj dhe vlerësimi i raportit të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 deri në 8 maj. Atëherë fillojmë me pikat e para të rendit të ditës, që kanë të bëjnë me rezultatet e verifikimeve, projektvendimet që lidhen me verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte deklaruese.

**Z. Y. Merhaj:** Faleminderit! Zoti Ded Pal Pali është regjistruar si kandidat te lista shumemërore e Bashkisë së Tiranës, mbështetur nga Partia Konservatore, e cila është miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Subjekti vetëdeklarues ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e deklarimit, ku nga verifikimi i këtij formulari konstatohet se ka deklaruar masa shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ka jetuar më shumë se një muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në vlerësim të përmbajtjes së vetëdeklarimit të mësipërm Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme të marrë informacione shtesë në lidhje me faktet e deklaruara në formularin e deklarimit. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për kryerjen e një hetimi të thelluar. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023*

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord. Atëherë do t'i përcjellim për verifikim të thelluar të dhënat e formularit të vetëdeklarimit për kandidatin zotin Ded Pal Pali, kandidat për anëtar i këshillit bashkiak, propozuar nga Partia Konservatore për Bashkinë e Tiranës. Po.

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Ervin Pjetër Gjoni është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë së Lezhës mbështetur nga Partia Socialdemokrate dhe ka depozituar formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit ka deklaruar që ka masa shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ka jetuar më shumë se 1 muaj jashtë Shqipërisë. Në këto kushte, duke qenë se bazuar në formularin e vetëdeklarimit, KQZ-ja nuk mund të marrë informacione jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i kërkojmë Komisionerit dërgimin e të dhënave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për kryerjen e verifikimit të thelluar ndaj këtij subjekti të deklaruesit. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord edhe për kandidatin për këshillin bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate për Bashkinë e Lezhës, zotin Ervin Pjetër Gjoni, do të vendosim për të dërguar në organin e prokurorisë për verifikim të thelluar të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit.

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Mark Pal Nika është regjistruar si kandidat për anëtar i këshillit të Bashkisë së Lezhës mbështetur nga Partia Socialdemokrate, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

formularit, ka deklaruar që ka marrë masa shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka jetuar më shumë se 1 vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se kërkohet marrja e informacionit shtesë në lidhje me këto fakte të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, i kërkojmë Komisionerit dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për kryerjen e verifikimit të thelluar ndaj këtij subjekti vetëdeklarues. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po edhe për këtë subjekt, pra, për zotin Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate për Bashkinë e Lezhës, do të dërgojmë për verifikim të thelluar të të dhënave të deklaruara nga ky subjekt në formularin e vetëdeklarimit.

**Z. Y. Merhaj:** Zoti Dejson Behar Kuqja është regjistruar si kandidat për anëtar i këshillit të Bashkisë së Elbasanit mbështetur nga Partia Bindja Demokratike. Kandidati për anëtar i këshillit bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit rezulton se ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me masa shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka jetuar më shumë se 1 muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se kërkohet informacion shtesë në lidhje me faktet e deklaruara në formularin e deklarimit, i propozojmë Komisionerit dërgimin e të dhënave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues Dejson Behar Kuqja. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

**Z. I. Celibashi:** Po edhe për këtë rast, pra për kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga Partia Bindja Demokratike për Bashkinë e Elbasanit, zotin Dejson Behar Kuqja, do t'i kërkojmë organit të prokurorisë për të bërë verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit.

**Z. Y. Merkaç:** Qazim Halil Bici është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë së Shijakut, i mbështetur nga Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit ku nga verifikimi i formularit konstatohet se ka deklaruar të dhëna mbi masat shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ka jetuar më shumë se 1 vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se informacioni për marrjen e këtyre të dhënave nuk është kompetencë e KQZ-së, i kërkojmë Komisionerit dërgimin e të dhënave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për kryerjen e verifikimit të thelluar ndaj subjektit vetëdeklarues Qazim Halil Bici. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, do t'i dërgojmë organit të prokurorisë për të bërë verifikimin të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë së Shijakut nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, zotin Qazim Halil Bici.

**Vendimet nr. 474, 475, 476, 477, 478.**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023*

10.05.2023

Ora, 14:13

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 21 prill -27 prill 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 342 ID, 343 ID, 344 ID, 345 ID, 346 ID, të deputetes, zonjës Albana Vokshi, të denoncimeve nr. 355 ID, 356 ID, 360 ID, 361 ID, 362 ID, 363 ID, të zotit Ivi Kaso, që lidhen me këtë periudhë”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti Politike:**                                      **S’ka**
- **Të tjerë:**    **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër, që ka të bëjë me vlerësimin e raportimit të veprimtarive me karakter publik të institucione publike për periudhën 21 prill deri në 27 prill, si dhe denoncimeve të cilat janë paraqitur nga zonja Albana Vokshi, nga KRIIK-u dhe nga zoti Ivi Kaso, për veprimtarinë e institucioneve, pikërisht për këtë periudhë.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

**Znj. M. Koja:** Për sa i përket periudhës 21 prill - 27 prill 2023 në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike janë raportuar gjithsej 162 aktivitete nga 50 institucione. Nga verifikimi rezulton se nga këto, 17 aktivitete, nga 8 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Nga këto janë ndaluar 7 veprimtari për Bashkinë e Maliqit për shkelje të afatit të raportimit. Për sa u përket institucioneve të tjera konkretisht: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshillit të Qarkut Vlorë, Bashkisë së Kolonjës, Bashkisë së Korçës dhe Bashkisë së Pogradecit propozojmë pushimin e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes. Arsyet ligjore ku e bazojmë këtë propozim kanë të bëjnë me sa parashtrojmë në vijim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Qarkut të Vlorës nuk kanë pasur mundësi të raportojnë në kohë për këto aktivitete, pasi kanë qenë në cilësinë e të ftuarit, pra kanë raportuar në cilësinë e të ftuarit. Veprimtaria e zhvilluar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për nga natyra e saj është një veprimtari administrative funksionale e këtij institucioni, kështu që nuk mbart detyrim për t'u raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa për sa u përket bashkive të Kolonjës dhe Pogradecit është thjesht një gabim material, gjatë raportimit kanë referuar muajin pararendës, kështu që në këtë kuptim janë brenda afatit ligjor të kërkuar. Ndërsa për sa i përket tematikës “Konkurs rinor talentesh” veprimtari e raportuar nga Bashkia e Korçës, kjo është një veprimtari e saj që nuk ka elementet për t'u konsideruar si veprimtari publike e për të cilën ka detyrim për raportim. Gjatë periudhës 21 - 27 prill 2023 janë administruar disa denoncime, për të cilat është zhvilluar edhe hetimi administrativ dhe sot jemi në

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

fazën përmbyllëse për shpalljen e tyre. Për sa i përket denoncimit me nr. ID 343 dhe 361 me denoncues deputeten zonja Albana Vokshi, denoncues zotin Ivi Kaso ndaj zonjës Festime Mjeshtri, drejtore e Shërbimit Spitalor në Bulqizë, ne zhvilluam seancën dëgjimore, ku u ftuan të merrnin pjesë pala denoncuese dhe spitali i Bulqizës dhe nga sa konkludohet në përfundim të hetimit dhe të provave të administruara, ne mendojmë që është kompetencë e institucionit, ku zonja Mjeshtri ushtron detyrën e saj për të vendosur në lidhje me legjitimitimin për dhënien apo jo të dorëheqjes se saj nga funksioni i drejtorit, në momentin që mban dhe statusin e kandidatit për kryetar bashkie. Në këto kushte vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ nga ana jonë dhe t'i përcillet për kompetencë ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord po cilës periudhë i përket kjo?

**Znj. M. Koja:** Periudhës që ne sot kemi monitorimin, 21 prill 27 prill.

**Z. I. Celibashi:** Dakord, po.

**Znj. M. Koja:** Ndërkohë për sa i përket denoncimit me nr. ID 344 të zonjës Albana Vokshi ndaj Emirjana Sakos, kandidate për kryetare e Bashkisë së Durrësit kemi kryer hetim të plotë, janë thirrur palët dhe kanë paraqitur pretendimet e tyre si shkresërisht, ashtu edhe në seancën publike të zhvilluar nga Komisioneri. Gjatë hetimit nuk u konstatua përdorimi i burimeve publike në funksion të fushatës dhe

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**



**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

për sa më sipër vlerësojmë që të pushohet ky hetim administrativ, të mos konstatohet shkelja e Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Po dakord.

**Znj. M. Koja:** Sërish për sa u përket denoncimeve me nr. 342 dhe 356 nga zonja Albana Vokshi dhe zoti Ivi Kaso ndaj Emirjano Sakos, kandidatë për kryetare e Bashkisë së Durrësit, pra për sa u përket takimeve të organizuara nga kjo e fundit me nxënës të arsimit parauniversitar, sipas denoncuesit ka denoncime të qytetarëve dhe nxënësve që tregojnë se i kanë nxjerrë më herët nga mësimi. Gjatë hetimit kjo në fakt nuk u provua, ndaj vlerësojmë se që të konstatohet shkelje duhet të vlerësohet përdorimi i detyruar dhe organizimi i aktivitetit brenda orarit mësimor. Gjatë hetimit, referuar provave nuk u arrit të provohej pjesëmarrja e detyruar dhe e organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit parauniversitar. Gjithashtu, nuk u provuan dot premtimet apo dhënia e përfitimeve për të marrë pjesë në veprimtari apo ushtrimi i presionit ndaj tyre. Kështu që në këto kushte propozojmë pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes të Kodit Zgjedhor nga zonja Sako.

**Z. I. Celibashi:** Po.

**Znj. M. Koja:** Denoncimi tjetër është nga zonja Vokshi dhe zoti Kaso, që janë 2 denoncime për të njëjtin objekt, kundër zotit Edison Memolla i Bashkisë së

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

Rrogozhinës, denoncuar për veprimtarinë në shpërdorim të burimeve publike. Është publikuar një denoncim nga koalicioni “Bashkë Fitojmë” për Bashkinë e Rrogozhinës, ku vërtetohet presioni dhe kërcënimi i vazhdueshëm që u bëhet mësuesve, që refuzojnë të marrin pjesë në takimet elektorale të Partisë Socialiste, duke i kërcënuar me largim nga puna. Është i njëjti rast si ai që arsyetua më lart. Gjatë hetimit administrativ nuk u vërtetua as nga denoncuesi, po as nga ana jonë përdorimi i detyruar për të marrë pjesë në aktivitete me përmbajtje elektorale. Veprimtaritë janë zhvilluar jashtë orarit zyrtar të punës, kështu që ne sugjerojmë pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatim të shkeljes në këtë rast.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord!

**Znj. M. Koja:** Për këtë periudhë kemi dhe denoncimin ndaj Bashkisë së Kukësit kryetarit të Bashkisë së Pukës, njëkohësisht kandidatit, zoti Gjici, denoncuar për veprimtari me shpërdorim të burimeve publike. Janë denoncimet nr. 346 dhe nr. 360 nga zonja Albana Vokshi, deputete, dhe zoti Ivi Kaso. Në fakt, përmbajtja e denoncimeve është e një fushe të gjerë për sa i përket promovimit në rrjete sociale të disa veprimtarive për rehabilitimin e rrugëve me tematikë takime me nxënës të gjimnazit dhe stafin, takime me stafin e kopshteve dhe të çerdheve dhe shpërndarje e pakove dhe ndihmave për familjet në nevojë. Hetimi është ende në fazë shqyrtimi, nuk e kemi ende të plotë panoramën e asaj që duam të sjellim deri në momentin e vendimmarrjes, një pjesë e provave të administruara janë drejt përfundimit, por nuk kemi marrë ende shpjegime nga Bashkia Pukë për sa u përket

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

disa momenteve të denoncimit sikundër është takimi me stafin e nxënësve dhe mësuesve të shkollës “Havzi Nela” apo në lidhje me shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë. Kështu që do të sugjeroja që vetëm për këtë pikë të marrim vendim në një moment të dytë.

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Do ta shtyjme sa të marrim informacionin e kërkuar.

**Z. M. Koja:** Denoncimi ndaj Bashkisë Kuçovë, kryetarit dhe kandidatit, zotit Kreshnik Hajdari. Është një denoncim i zotit Ivi Kaso, me nr. 355 ID, është përfshirja në fushatë elektorale e zotit Hajdari me punonjës të bashkisë dhe institucione të tjera publike, ku janë listuar emra të përveçëm të punonjësve të bashkisë. Aktivitetet në fjalë janë zhvilluar jashtë orarit të punës, pra janë pas përfundimit të orarit të punës, u pohua nga pala e denoncuar që një pjesë e tyre janë punonjës të bashkisë, por që të mund të konstatohet shkelje duhet të vërtetohet përdorimi i detyruar i administratës, gjë të cilën denoncuesi nuk e provoi dot gjatë hetimit administrativ. Për sa më sipër vlerësojmë të pushohet hetimi administrativ dhe moskonstatimi i shkeljes.

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Edhe për këtë rast do të vendosim pushimin e hetimit administrativ.

**Z. M. Koja:** Denoncimi tjetër është nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Lushnjë. Është një zhvillim veprimtarie nga Bashkie Lushnjë, është panairi “Ditët e bujqësisë” në

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023**

kundërshtim me legjislacionin për veprimtaritë publike në fushatë. Nga verifikimi i të dhënave rezultoi se Bashkia Lushnjë ka përmbushur detyrimin për ta raportuar këtë veprimtari në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afateve ligjore dhe në mbështetje të dokumentacionit që kemi disponuar, provave dhe fakteve gjatë hetimit, mendojmë që nuk ka elemente për të konstatuar shkelje për këtë veprimtari të Bashkisë Lushnjë, ndaj sugjerojmë pushimin e hetimit dhe moskonstatimin e shkeljes.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord!

**Z. M. Koja:** Denoncimi tjetër është ndaj Bashkisë Tiranë, kryetarit të Bashkisë Tiranë për një veprimtari në keqpërdorim të burimeve publike. Denoncues është KRIIK, denoncimi me nr. 348 ID. Kryetari i Bashkisë Tiranë ka përdorur mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak të datës 19 prill dhe pozicionin e tij si kryetar bashkie për të bërë fushatë elektorale në favor të tij dhe subjektit që përfaqëson. Në fakt, ne dalim me këtë konkluzion në përfundim të këtij hetimi administrativ: nuk u arrit të provoheshin thëniet e zotit Veliaj në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe, duke qenë se nga provat e vëna në dispozicion janë thjesht pohime të KRIIK, por nuk ka material video të vënë në dispozicion nga ana e tyre, ne mendojmë që nuk kemi një bazë të mjaftueshme të dhënash për të konstatuar shkeljen. Në këtë rast propozojmë pushimin e hetimit administrativ.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord!

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 10.05.2023*

**Z. M. Koja:** Këto janë denoncimet e administruara për periudhën 21 prill-27 prill 2023.

**Z. I. Celibashi:** Me përjashtim të rastit të Kukësi që është mbyllur vlerësimi i kësaj veprimtarie.

**Z. M. Koja:** Është monitoruar edhe periudha 28 prill - 4 maj 2023. Gjatë kësaj periudhe të dytë të monitorimit janë raportuar në total 162 aktivitete nga 50 institucione. 18 veprimtari nga këto 162 janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Jemi në përfundim të procesit të shqyrtimit të arsyeve përse kemi tejkalim të afatit ligjor dhe besoj që brenda ditës së nesërme do të dalim me vendim edhe për këtë periudhë raportimi.

**Vendimi nr. 481**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

10.05.2023  
Ora 14:27

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 210 ID, 237 ID, 238 ID, 239 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”, ndaj bashkive Belsh, Roskovec, Lushnjë, Elbasan”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Staf i KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti Politike:**                                      **S’ka**
- **Të tjerë:**    **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord! Kemi shpalljen e vendimit për disa denoncime nga KRIIK. Bashkia Belsh.

**Z. M. Koja:** Në rend të ditës kemi denoncimin e KRIIK me nr. 210 ID ndaj Bashkisë Belsh, ndaj zotit Arif Tafani, kryetar i Bashkisë Belsh. Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, ky është një aktivitet që është konsideruar i lejuar për t’u zhvilluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pjesëmarrja e deputetëve nuk e bën detyruesisht të ndaluar veprimtarinë, por nga verifikimi i provave është vërejtur se gjatë këtij takimi janë përdorur thënie me natyrë tërësisht elektorale, si dhe thirrje për mbështetje duke e bërë aktivitetin jo më institucional,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

por elektoral. Ndaj ne sugjerojmë të vendoset sanksion ndaj kryetarit të Bashkisë Belsh.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Do ta pranojmë kërkesën e KRIIK dhe do të urdhërojmë vendosjen e sanksionit për kryetarin e Bashkisë Belsh.


**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë.

**Z. M. Koja:** Kemi shpalljen e vendimit për denoncimin e KRIIK, denoncim me nr. 237 ID ndaj Bashkisë Roskovec, ndaj zonjës Majlinda Bufi. Objekt denoncimi është inspektim punimesh për rikualifikimin urban të qendrës së Marinzës, e cila përfshin sistemim trotuaresh, ndriçim, lulishte etj., me pjesëmarrje të drejtuesit politik, zoti Taulant Balla. Nga këqyrja e materialit video që na është vënë në dispozicion, rezulton që në këto takime nuk evidentohen thirrje elektorale apo fjalime politike si nga zoti Balla, ashtu edhe nga kryetarja e bashkisë dhe kandidatja, zonja Bufi. Në këto kushte ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes për këtë rast.

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Bashkia Lushnjë, denoncimi për kryetaren e Bashkisë Lushnjë.

**Z. M. Koja:** Shpalljen e vendimit ndaj Bashkisë Lushnjë, kryetares dhe kandidates, zonjës Sefa, denoncues është sërish KRIIK, me denoncimin nr. 238. Vizitë në lagjen “Loni Dharmo” është denoncimi, me rastin e nisjes së punës për veshjen e fasadave të pallateve në këtë lagje, me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë dhe drejtuesit politik, zotit Balla. Ky është një aktivitet i raportuar në ndërfaqen e KQZ-së brenda

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*


afateve ligjore të përcaktuara. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe provave të vëna në dispozicion, nuk konstatohen thirrje elektorale apo fjalime politike gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, as nga kryetarja e bashkisë, as nga zoti Balla. Në këto kushte propozojmë pushimin e hetimit administrativ për kryetaren e Bashkisë së Lushnjës, zonjë Sefa.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord.

**Z. I. Celibashi:** Kemi dy denoncime për Bashkinë e Elbasanit, shpallje vendimi.

**Z. M. Koja:** Atëherë, kemi pikat 11, 12, 13 dhe 14 të rendit të ditës, që janë në fakt denoncime për katër veprimtari me përmbajtje elektorale. Denoncues është KRIIK, i denoncuari është Bashkia Elbasan. Janë katër veprimtari: inspektim punimesh për rehabilitim të plotë të rrugës në lagjen “Haxhias” dhe “5 Maji”, me pjesëmarrje të kryetarit të bashkisë dhe drejtues politik të qarkut Elbasan, Ministrisë së Arsimit; takim me rastin e fillimit të punimeve për rehabilitim dhe asfaltim të rrugëve në disa fshatra në njësi administrative të qarkut Elbasan, me pjesëmarrjen e dy deputetëve, zotit Gjijnuri dhe zonjës Tahiraj; inspektime punimesh për rehabilitimin e rrugës në fshatin Kusarth, njësia Bradashesh, edhe këtu me pjesëmarrjen e zotit Gjijnuri dhe zotit Duzha; inspektim punimesh për rehabilitim të rrugës “Riza Salla”, Shushicë, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë, të zotit Gjijnuri dhe zonjës Tahiraj. Të katërta këto aktivitetet janë publikuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë. Të katërta aktivitetet janë raportuar edhe në ndërfaqen e raportimeve në KQZ. Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, këto veprimtari janë konsideruar të lejuara për t’u zhvilluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjatë verifikimit të provave që na janë vënë në dispozicion, materiale filmike, rezulton që

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*


gjatë fjalës së deputetëve Gjiknuri, Tahiraj apo edhe të kryetarit të bashkisë, janë vërejtur thënie me natyrë elektorale në takim, duke e bërë këtë aktivitetet jo më institucional, por elektoral. Në këto kushte ne propozojmë sanksion ndaj kryetarit të bashkisë Elbasan.

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Do të kërkojmë vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Elbasan për këto veprimtari. Tjetër?

**Z. M. Koja:** Përfundojmë shpalljen e vendimeve për këto pika të rendit të ditës.

**Vendimi nr. 480**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

**10.05.2023  
Ora 14:31**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shpalljen e vendimit mbi denoncimin nr. 326 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti Politike:**      **S’ka**
- **Të tjerë:**      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë.

**Z. V. Ballgjini:** Mbi denoncimin nr. 326 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë për vendosjen e materialeve propagandistike në Bashkinë Tiranë. Organizata KRIIK denoncon se subjekti zgjedhor Partia Socialiste ka afishuar në vendet e reklamave ndriçuese buzë rruge, ku zakonisht vendos reklamat me pagesë, materialet propagandistike të subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Është publikuar poster i përgatitur dhe shpërndarë me logo të Partisë Socialiste, i cili në vetvete, në analizë të përmbajtjes sipas opinionit të KRIIK, përmban elemente të forta të diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes, totalisht pa asnjë lidhje me një proces zgjedhor, llojin e zgjedhjeve për të cilën garohet dhe mesazheve që përcjell. Këta postera janë


**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

vendosur në vendet e afishimit të reklamave në thuajse të gjitha rrugët kryesore të Tiranës, madje deri në rrugët anësore të autostradës Tiranë – Durrës deri pranë mbikalimit të Rinasit. Në vijim të procedurave të hetimit administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kërkuar subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë nëpërmjet së cilës i kërkon informacion, procedurën e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë apo subjekteve të kontraktuara prej saj për afishimin e këtyre materialeve propagandistike dhe arsyet e mosvendosjes së shënimit në materialin propagandistik sipas përcaktimeve të kërkesave të nenit 79, pika 3, prodhuar nën përgjegjësinë ligjore dhe më pas të vijojë emri i subjektit. Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka urdhëruar menjëherë monitoruesit e qarkut Tiranë për të verifikuar rastet objekt denoncimi. Monitoruesit vendosën në dispozicion të KQZ-së 6 raporte monitorimi nëpërmjet të cilave konstatohen shkeljet e pretenduara nga denoncuesi, si dhe çdo raport është i shoqëruar me foto të materialeve propagandistike. Në seancën publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 25 prill 2023, Komisioneri i kërkoi që subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” brenda 48 orëve të vendosë në dispozicion të KQZ-së të gjitha marrëveshjet kontraktuese, të bëra nga Partia Socialiste e Shqipërisë me subjekte tregtare për afishimin e materialeve propagandistike. Brenda afatit të përcaktuar 48 orë që iu la nga Komisioneri, Partia Socialiste e Shqipërisë ka sjellë në KQZ kopjet e kontratave të lidhura me dy kompani private, respektivisht kontratë e lidhur në datën 11 prill 2023 me kompaninë DIXHI PRINT, objekt i kontratës është dhënia e hapësirave publicitare në rrugët nacionale për fushatë dhe zgjedhjet lokale 2023 dhe kontratë e lidhur në datën 14 prill 2023 me kompaninë B.N.I sh.p.k., objekt i kontratës është bashkëpunimi në realizimin e programit publicitar në “*outdoor advertising*” në ekranet Led Display. Referuar pikës 2 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton përdorimin e afishimit të materialeve propagandistike

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

statike, lejohen në largësi, pra vendet e lejuara të tyre. Referuar denoncimit të mësipërm, vendosja e materialeve propagandistike është bërë në stenda afishimi *bill border led* që janë vendosur në Bashkinë e Tiranës. Ligji parashikon që subjektet private mund të pajisen me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, për qëllime të ndryshme ndër të cilat është edhe reklamimi. Bashkitë miratojnë rregullat përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave publike duke përcaktuar afatet e lejes; dokumentacionin e nevojshëm; afatin e shqyrtimit dhe specifikimet të tjera. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm stendat e afishimit *bill border* konsiderohen prona private pasi për to është marrë leje specifike për përdorimin e hapësirave publike nga subjekte që ushtrojnë aktivitete reklamuese për *siti lait* dhe tabela reklamuese. Në këto kushte ne propozojmë që nuk mund të vazhdojë shqyrtimi i hetimit administrativ për kallëzimin e kryer nga organizata KRIIK, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 79. Sa i përket afishimit të materialeve propagandistike, të cilat nuk përmbajnë shënimin prodhuar nën përgjegjësinë ligjore ju rikujtojmë edhe një herë vendimin numër 424 të Komisionerit që i janë ngarkuar Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për identifikimin e këtyre materialeve propagandistike që nuk e përmbajnë këtë shënim dhe heqjen e menjëhershme të tyre. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po praktikisht për një pjesë të denoncimit që ka sjellë KRIIK, ne kemi pasur vendimmarrje të mëparshme, kështu që për një pjesë konsiderohet i ezauruar ai si shqetësim i paraqitur. Dakord.

**Vendimi nr. 483**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

10.05.2023  
Ora, 14:38

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për vlerësimin e raportit të Autoritetit të Medias  
Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për  
periudhën 1-5 maj 2023”**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
P.Doçaj, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin e raportit të AMA-s për periudhën 1- 5 maj.

**Znj. V. Ballgjini:** Referuar vendimit numër 37, datë 5 maj 2023 të AMA-s, “Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 maj 2023” konstatohet sa vijon nga AMA: Për depozitimin e regjistrimeve në AMA, subjektet audivizive, janë 5 subjekte audiovizive, të cilat nuk kanë paraqitur regjistrime pranë AMA-s nga data 1 deri më 5 maj. AMA i propozon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për këto 5 OSHMA, të procedohet në marrje


*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

masash administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Lidhur me të dhënat mbi edicionet informative, pika 2 e nenit 80 të Kodit Zgjedhor, parashikon se radiotelevizioni publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizimit të informacionit të parashikuar në legjislacionin që rregullon fushën e medieve elektronike. AMA, i propozon Komisionerit shtetëror të zgjedhjeve që të procedohet me masën administrative për televizionin publik RTSH, për mosrespektim të kohës së barabartë për të gjitha partitë parlamentare. Në datën 9 maj është administruar një imail i dërguar nga RTSH-ja, nga zoti Zaganjori, i cili shprehet se nuk ka dispozitë ligjore që t'i sugjerojmë marrjen e masave administrative ndaj një OSHMA-je në mes të fushatës zgjedhore, kur nuk ka kryer një shkelje flagrante të ligjit. Kodi Zgjedhor dhe udhëzimi i KQZ-së për ndarjen e kohës televizive për subjektet politike në medie nuk parashikojnë që të merren masa nëse OSHMA-të nuk balancojnë kohën për një ditë për një javë apo për 20 ditë siç është rasti konkret. Kjo do të ishte vetëm në përfundim të fushatës zgjedhore. Për shkak të angazhimeve në fushatë kandidati i Partisë Demokratike për Tiranën nuk i është përgjigjur kërkesave për të qenë pjesë e një segmenti në emisionin “Një ditë në fushatë” që transmetohet të dielave nga Televizioni Shqiptar një në orën 23:00. Kandidati i Partisë Demokratike ka qenë ditën e martë, më datë 9 maj, në një emision publikisht. Në kohën e kandidatit ditën e martë 9 maj dhe ritransmetimi i emisionit më datën 10 maj, në orën 13, balancon kohën e dy kandidatëve të tjerë, atij të koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe atij të Partisë Socialiste në dy javët paraardhëse. Monitorimi i AMA-s duke qenë i pjesshëm jo për të gjithë kohën e fushatës, por vetëm për 20 ditë ka nxjerrë të pabalancuar kohën televizive të tre kandidatëve, por AMA nuk mund të dalë në vlerësime përfundimtare kur fushata është ende duke u zhvilluar. Gjithashtu, për emisionin “Një ditë në fushatë dhe kandidati”, RTSH-ja ka

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

hasur probleme me kandidatët në zgjedhje, të cilët shpeshherë nuk i janë përgjigjur ftesave për të qenë të pranishëm në emisionet e tyre zgjedhore, përfshirë këtu edhe kandidatin e Partisë Demokratike. Kjo ka bërë që të detyrohen dhe të gjejnë forma të tjera për të kompensuar kohën e tyre televizive dhe lidhur me disbalancën që AMA pretendon në emisionet informative në “RTSH1”, edhe pse është shumë e kufizuar, kjo varet më së shumti nga vonesa e fillimit të aktivitetëve të Partisë Demokratike, të cilat kanë qenë shumë të pakta në ditët e para të fushatës, edhe nga numri i kufizuar i tyre për shkak të mungesës edhe të kandidatëve ndoshta në të gjitha Shqipërinë. Pavarësisht jemi munduar të balancojmë sa më shumë kohën televizive në edicionet informative dhe synojmë të arrijmë në një balancë sa më të pranueshme për të gjitha subjektet zgjedhore deri në fund të fushatës zgjedhore. Ky është imaili të cilin Radiotelevizioni Shqiptar e ka sjellë nëpërmjet zotit Zaganjori. Gjithashtu, AMA i propozon Komisionit Qendror të zgjedhjeve që OSHMA- të private sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës për periudhën 14 prill-5 maj 2023 të bëjnë në vijim kompensim në kohë transmetimi në edicionet informative për efekt balancimi. Të dhënat mbi reklamat politike, sipas raportit të AMA-s, OSHMA-ja “Shijak Televizion” dhe “Syri TV”, kanë tejkalluar kohën prej 90 minutash për njërin prej subjekteve zgjedhore konkurruese. Konkretisht koha për OSHMA-në “Shijak Televizion” është tejkalluar me 298.32 minuta dhe në total për këtë 20 ditësh është 388.32 minuta janë reklama televizive të publikuara nga “Shijak Televizion”. Ndërkohë “Syri TV” ka tejkalluar kohën 90 minuta me 18.97 minuta, pra në total 109 minuta kohë reklamë televizive për njërin prej subjekteve zgjedhore. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që t’iu kërkojë dy OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar dhe lejuar nga Kodi Zgjedhor. Doja të sillja në vëmendje që, lidhur me OSHMA-në “Shijak Televizion”, AMA ka sjellë këtë problematikë të ngritur edhe në raportin e

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

dytë të miratuar prej nesh. Ndërkohë me vendimin numër 451 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndërprerjen e transmetimit të reklamave për subjektin zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në OSHMA-në “Shijak Televizion”, nga ku rezulton që nga raporti i tretë Shijak Televizion vazhdon dhe transmeton reklama të këtij subjekti zgjedhor. Gjithashtu, lidhur me këtë pikë, janë edhe 6 OSHMA që kanë transmetuar reklama jashtë fashave orare të lejuara. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i kërkojë këtyre 6 OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike në kohën e ndaluar. AMA, gjithashtu ka identifikuar që OSHMA-ja “Syri TV”, ka transmetuar reklamë politike në edicionin e lajmeve konkretisht në datat 2, 3 dhe 4 maj. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i kërkojë kësaj OSHMA-je të ndërpresë transmetimin e reklamës politike brenda edicionit të lajmeve. Lidhur me përfaqësinë gjinore në fushatë AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatë zgjedhore.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Nga ajo çfarë u referua dhe çfarë rezulton në vlerësim të raportit të AMA-s do të vendosim masë administrative me gjobë në vlerën e 5 mijë lekëve për operatorët televizivë, të cilët nuk kanë depozituar regjistrime pranë AMA-s: “Gold TV”, “Channel Seven”, “TV1 Channel”, “Tv Klaudiana” dhe “Saranda TV”. Ndërkohë urdhërohen të gjithë OSHMA-të të bëjnë menjëherë kompensimin në kohë transmetimit në edicionet informative për efekt të balancimit. Do të vendosim sanksion administrativ me gjobë në masën e 40 mijë lekëve për televizionin “Shijak TV”, do t’i kërkohej këtij televizion, por edhe televizionit “Syri TV”, që të ndërpresin reklamat politike për koalicionin “Bashkë Fitojmë” për shkak të tejkalimit edhe pse në rastin e televizionit “Syri TV”, tejkalimi është prej vetëm

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

18 minutash, por gjithsesi është më shumë se 1 minutë mbi atë që përcakton ligji. Edhe ndërkohë për televizionet vijuese urdhërohet ndërprerja e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore: “Shijak TV”, “Fax News”, “Syri TV”, “Klan Plus”, “Vizion Plus” dhe “TV Bulqiza”. Ndërkohë i tërheqim vëmendjen të gjithë operatorëve radiotelevizivë për të respektuar kriterin e përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore. Këto ishin masat që vendosim në vlerësim të raportit të AMA-s, për periudhën e monitorimit 1-5 maj.

**Vendimi nr. 479**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

10.05.2023  
Ora, 14:48

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës  
zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 maj deri më 8 maj 2023.”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. P. Daçaj, Znj. V. Ballgjini.**
- **Parti Politike:**      **S’ka**
- **Të tjerë:**      **KRIIK, OSBE/ODIHR**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Znj. V. Ballgjini:** Vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2-8 maj 2023. E kemi referuar në seancën e mëparshme për të gjitha gjetjet që monitoruesit kanë sjellë nëpërmjet raporteve të tyre, të cilat janë të vërtetuara lidhur me materialet propagandistike, të cilat nuk mbajnë shënimin: “Prodhuar në përgjegjësinë ligjore”, gjithashtu dhe për hapje të zyrave elektorale nga disa subjekte zgjedhore në afërsi të qendrave të votimit KZAZ-ve dhe VNV-ve. Për shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore” propozojmë ngarkimin e Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për heqjen e të gjitha materiale propagandistike, të cilat nuk përmbajnë

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.05.2023*

shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore”. Për Bashkitë Gjirokastrë dhe Elbasan është i njëjti propozim. Si dhe për mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore në Bashkinë e Tiranës të subjektit zgjedhor Partisë Socialiste e Shqipërisë, pallati N, te blloku Gintash, në katin e parë ku zyra zgjedhore është 123 metra afër Qendrës së Votimit në shkollën “Aleks Buda”.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord, do të urdhërohet mbyllja e kësaj zyre elektorale të subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe ndërkohë do t’i kërkohej Policive Bashkiake respektive në të gjitha rastet një raport tjetër në lidhje me zbatueshmërinë e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda ditës së nesërme, përfshirë jo vetëm vendimet për vendosjen e materialeve propagandistike dhe për përhapjen e zyrave zgjedhore në kundërshtim me ligjin, për të cilat ditë më parë urdhëruam mbylljen e tyre. Dakord. Përfunduar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mirë dakord e vlerësojmë dhe e shikojmë. Dakord, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 482**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*

